




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.02.2023

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe individëve në fushat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale me këto aktivitete.
 - Promovimi dhe përkrahja e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe sociale të familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale
 - Lehtësimin e gjendjes së kategorive të personave me nevoja të veçanta:
 - Ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e kategorive të personave në nevojë të cilët janë të organizuar në shoqata të ndryshme:
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si vijon:
 - 2.1. Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale me këto aktivitete.
 - 2.2. Mjetet financiare për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e entiteteve jopublike dhe individëve që promovojnë avancimin, fuqizimin dhe masivizimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
 - 2.3. Vlera totale e planifikuar për këtë thirrje publike është në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej 40,000.00€, nga fondi burimor 21 dhe 22, kodi ekonomik 21/612/73011/21200/00000/0760, në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale .
 - 2.4. Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 4,000.00€;
3. Mjetet financiare të planifikuara në pikën 2, paragrafi 2.3 do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve sipas dokumentacionit valid për zbatimin e thirrjes, i cili është pjesë e këtij vendimi.
4. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është pesëmbëdhjetë ditë pune dhe fillon në ditën e thirrjes publike, nga 08.02.2023 deri më 01.03.2023.

5. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një ditë dhe maksimumi një vit.

6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim. Dokumentacioni i kompletuar në zarfën e mbyllur, gjithashtu në usb e cila duhet të jetë brenda zarfit, duhet të dorëzohet në mënyrë fizike në adresën e komunës rruga 'Tahir Zemaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës dhe on-line në adresën: hysen.sllamniku@rks-gov.net. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në e-mail-adresën e cekur më lartë.

7. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë Komisioni Vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1 të vendimit.

8. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuarit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve.

9. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuarin e suksesshëm që mund të përkrahjet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, udhëheqësi mbështetur ne rekomandimet e Komisionit Vlerësues merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekteve, propozimeve dhe programeve të OJQ-ve dhe individëve që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe masivizimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, siç janë të profilizuara në nenin 1 të këtij vendimi.

10. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Fushë-Kosovës.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Sqarim: OJQ-të dhe individët të cilët nuk i kanë mbyllur projektet paraprake (dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar) nuk do të shqyrtohen fare nga komisioni për vlerësim.

Akti i dorëzohet:

1 x Kryetarit të Komunës

1 x Drejtorisë së FB

1 x Drejtorisë së SHMS

1 x Arkivit

